



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR**

**RREGULLORE**

**Nr. 7 datë 07.09.2018**

**PËR INVESTIGIMIN DHE PROCEDURAT PËR MARRJEN E MASAVE DISIPLINORE**

Kjo rregullore është hartuar në bazë Statutit të IKM kapitulli IV, nenet 41-45 si dhe Ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar" i ndryshuar me ligjin nr.10297 datë 08.07.2010 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", me ligjin 47/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, si dhe të rregullores Nr. 4 datë 29.03.2018 "Për Investigimin dhe Procedurat për Marrjen e Masave Disiplinore" të emetuar nga BMP.

**Neni 1**

**Qëllimi dhe objekti i kësaj rregulloreje**

1. Kjo rregullore ka për qëllim :
  - a) zbatimin e kërkesave të statutit dhe të ligjit për investigimin dhe marrjen e masave disiplinore nga ana e Keshillit të Drejtimit të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar.
  - b) të vendosë rregulla dhe procedura për të garantuar të drejtat e anëtarëve të institutit, në këtë proces.
  - c) të përcaktojë përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të procesit të investigimit dhe marrjes së masave disiplinore nga Keshilli i Drejtimit të IKM dhe parimet e përgjithshme për funksionimin e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës së një Kontabilisti të Miratuar dhe të shoqërive (firmave) të kontabilitetit vendase dhe të huaja, anëtare të IKM.
2. Kjo rregullore parashikon dispozitat që rregullojnë shqyrtimin e ankimeve ndaj KM dhe shoqërive që zhvillojnë aktivitetin si KM, vendosjen e masave disiplinore ndaj Kontabilistëve të Miratuar dhe zbatimin e tyre nga ana e IKM/Keshilli i Drejtimit në përputhje me kërkesat e statutit dhe legjislationin shqiptar.
3. Kjo rregullore gjithashtu parashikon dispozitat që rregullojnë :
  - a) marrjen e masave disiplinore ndaj të gjitha subjekteve/anëtarëve të cilat janë subjekt i drejtpërdrejt ose indirekt i mbikëqyrjes së IKM-së.



- b) investigimin e sjelljeve të gabuara të kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilistëve të miratuar mbi bazën informacioneve të besueshme dhe kuadrit rregullator në fuqi.
- c) verifikimin e ankesave të paraqitura pranë IKM-së nga anëtarët e saj.
- ç) dhënia e udhëzimeve të nevojshme anëtarëve të IKM-se lidhur me zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

## **Neni 2**

### **Organizimi dhe funksionimi i Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës (KID)**

1. Me qëllim zbatimin e rregullave dhe procedurave të vendosura në këtë rregullore dhe të tjera akteve rregullative për qëllime disiplinore të vendosura në rregullore të tjera, bazuar në nenin 42 të statutit të IKM, krijohet Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës pranë Këshillit të Drejtimit të IKM-së.
2. Këshilli i drejtimit i IKM nëpërmjet Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës ndërmerr vetë procesin e investigimit dhe disiplinës ndaj anëtarëve të saj.
3. Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës ngrihet në varësi të drejtpërdrejtë të Këshillit të Drejtimit IKM. Në raste të ankesave ndaj një anëtar të IKM, Kryetari i KID brenda 10 ditëve nga marrja e ankesës behet shqyrtimi i ankesës.
4. KID përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët, Kryetari dhe 2 anëtarët të cilët zgjidhen nga radhët e antarëve të IKM me një eksperiencë antarësie mbi 5 vjet dhe pa patur masa disiplinore të marra nga IKM me vendim të Këshillit të Drejtimit. Kryetari caktohet nga KD i IKM.
5. Cdo anëtar i KID do të kenë një mandat emërimi 2 vjeçar me të drejtë rizgjedhje deri në dy mandate. Në rast të mbarimit të mandatit anëtarët e KID do qëndrojnë në detyre deri në zgjedhjen e antarëve të rinj duke mos u kufizuar në ushtrimin e funksioneve të tyre deri në datën e zvëndësimit nga anëtarët e rinj.
6. Për të shmangur konfliktin e interesit anëtarët e komitetit duhet të konfirmojnë pavarësinë nga:
  - a. subjekti i kontrollit;
  - b. personat e lidhur ose të interesuar me rastin e kontrollit.
7. Në rastin e konfliktit të interesit anëtarët e komitetit duhet të tërhiqen menjëherë nga rasti duke u zevëndësuar përkohësisht nga një anëtar tjetër, i percaktuar sipas procedurave të perzgjedhjes së antarëve të KID-se.



8. Organizimi dhe funksionimi i KID së IKM-se bëhet përmes rregulloreve të hartuara nga KID dhe miratohen nga KD i IKM.
9. Mënyra e organizimit të këtij komiteti duhet të jetë në përputhje me Statutin e IKM dhe gjithë kuadrin rregullator të miratuar nga BMP.
10. BMP mund të japë rekomandime apo sugjerime lidhur me këto rregullore të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga IKM.

### **Neni 3**

#### **Objekti i veprimtarisë së KID**

1. Objekti i veprimtarisë së KID është shqyrtimi i ankesave të paraqitura nga anetarët e saj dhe shoqëritë e kontabilistëve të miratuar si edhe shqyrtimi i të gjitha ankesave apo informacioneve të tjera që lidhen me investigimin dhe disiplinën që vijnë pranë IKM/Keshillit të Drejtimit.
2. Objekti i veprimtarisë së KID janë edhe rastet kur anëtarët e IKM nuk e kanë kaluar me sukses kontrollin e cilësisë për shkak të mangësive të theksuara dhe janë paraqitur propozimet nga KKC i IKM.
3. Në përfundim të procesit KID duhet të raportojë tek Keshilli i Dejtimit të gjitha gjetjet dhe rastet e shqyrtuara dhe masat e propozuara.
4. Raporti duhet të përmbajë të paktën elementët si në vijim:
  - a. Një përshkrim për aktivitetin e kryer dhe rastet e shqyrtuara gjatë periudhës raportuese;
  - b. Rastet kur është shkelur ligji, statuti, rregulloret, rregullat, vendimet e IKM/KD-së dhe standardet e profesionit;
  - c. Propozimet dhe rekomandimet që parashikohen të ndërmerren në të ardhmen.
5. Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës i ngritur ka të drejtën të shqyrtojë edhe ankesat e ngritura nga palët e treta për antarët e tyre, si dhe të gjitha ankesave apo informacioneve të tjera që lidhen me investigimin dhe disiplinën që vijnë pranë tyre në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret e brendshme të tyre të miratuara nga KD pa rënë ndesh me dispozitat kësaj rregullore.

### **Neni 4**

#### **Detyrimi për dhënien e informacionit**

1. Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës së IKM-së bën të gjitha hapat e nevojshëm në përputhje me këtë rregullore për të marrë evidencën e duhur dhe dokumentacionin mbështetës të lidhur me rastin.



2. Anetaret e IKM dhe të gjitha subjektet e mbikëqyrjes të parashikuara në këtë rregullore janë të detyruar të dorëzojnë pranë Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës së IKM-së informacionin e kërkuar.
3. Në rast se ky informacion nuk dorëzohet në kohë subjektet e mbikëqyrjes së IKM-së do të jene objekt i masave disiplinore sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe kuadrit ligjor në fuqi.

**Neni 5**  
**Raportimi i**  
**KID**

1. KID harton një raport të veprimtarisë vjetore të cilën ia paraqet për miratim KD të IKM brenda muajit Shkurt të vitit pasardhës.
2. Raporti i KID duhet të përmbajë të paktën këto elemente:
  - a. një përshkrim mbi aktivitetin e kryer dhe proceset investigative që janë kryer gjatë periudhës raportuese;
  - b. shkeljet e ligjit, të akteve në zbatim të tij, të akteve statutoare apo të rregullave dhe të standardeve të profesionit që janë konstatuar gjatë proceseve investigative;
  - c. dobësitë dhe neglizhencat e konstatuara;
  - d. propozimet dhe rekomandimet për veprimet që priten të ndërmerren në të ardhmen;
3. Raporti i KID miratohet nga Keshilli i Drejtimit i IKM.
4. KID nëse ka sugjerime mund të ja propozojë Keshillit të Drejtimit për t'i adresuar si rekomandime përfundimtare për rishikimin e raportit. KD mund t'i adresojë rekomandimet edhe në mënyrë të pavarur pa qënë e nevojshme të marre një propozim nga KID.

**Neni 6**  
**Investigimi**

1. Procesi i investigimit do të kryhet nga KID për të gjitha rastet e parashikuara në këtë rregullore apo në vendimet e IKM-së që dalin në zbatim të kësaj rregullore.
2. Në mbyllje të procesit Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës duhet të dorëzojë pranë KD të IKM, raportin lidhur me të gjitha gjetjet dhe shmangiet që kanë ndodhur duke adresuar edhe rekomandimet që lidhen me masat disiplinore.



3. Në rast se KD vëren se evidencat e grumbulluara nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës të IKM janë të pa mbështetura apo të pamjaftueshme apo të pavlefshme juridikisht, atëherë ka të drejtën të mos i konsiderojë përgjatë procesit të dhënies së rekomandimit përfundimtar, kundrejt një vendimi të KD.
4. Procedura e investigimit të mëtejshëm, për rastet kur rezultatet e kontrollit të cilësisë janë të pakënaqshme bëhet me autorizim të KD-së, ku ky i fundit vepron në përputhje me këtë rregullore dhe procedurat e investigimit.

#### **Neni 7**

##### **Shkeljet që çojnë në Investigim dhe marrjen e masave disiplinore**

1. Në përputhje me këtë rregullore trajtohen të gjitha çështjet me shkelje ose sjellje të pa pajtueshme.
2. Me shkelje ose sjellje të papajtueshme do të nënkuptohet kur anëtari ka shkelur ose është shmangur nga rregullat, rregulloret dhe standardet profesionale teknike ose etike duke përfshirë edhe të mëposhtmet:
  - Kërkesat ligjore të ligjit që lidhen me ushtrimin e profesionit
  - Kërkesat statutores të IKM-së
  - Kërkesat e ardhura nga rregulloret, rregullat dhe vendimet e BMP-së
  - Kodin e Etikës së IKM-se ( të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë ose të njëjtë me Kodin e Etikës Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC) )
  - Aktivitetet kriminale
  - Veprimtari apo shkelje të cilat çënojnë anëtarin/subjektet në integritetin dhe imazhin e profesionit kontabël.
  - Një numër rastesh më pak serioze të neglizhencës profesionale që, kumulativisht, mund të tregojnë paaftësi për të ushtruar të drejtat e ushtrimit të profesionit
  - Punë të pakënaqshme siç janë mangësitë e dukshme të shpalosura në rishikimet që dalin të pasuksesshme përgjatë kontrollit të cilësisë
  - Mosdhënia e informacionit ose dhënia e informacionit të gabuar nga anëtari/subjekti KM.
  - Mosshlyerja e detyrimeve (të cilat çënojnë vijimësinë e veprimtarisë së IKM-së dhe mbrojtjen e interesave të publikut) nga anëtari në përputhje me kuadrin e zbatueshëm rregullator.



3. Investigimi mund të fillojë edhe mbi bazën e informacioneve të tjera jo ankesa. Në rastet kur KD disponon informacione të marra nga burime të sigurta, që tregojnë për mundësinë e sjelljes së keqe, shkeljeve apo papajtueshmërisë së antarëve të tij, ai autorizon KID për shqyrtimin e mundësisë së nisjes së procesit të investigimit.

Investigimi mbi bazën e informacioneve – jo ankesë, mund të kryhet si për veprimtarinë e drejtpërdrejtë profesionale ashtu dhe për çështjet që lidhen me zbatimin e detyrimeve të tjera që rrjedhin nga kuadri rregullator/ligjor si subjekt i mbikëqyrjes.

Për investigimet mbi bazën e informacioneve – jo ankesë koha dhe afatet duhet të përcaktohen në autorizimin e investigimit. Ky afat mund të shtyhet nga kryetari i KD bazuar në kërkesën KID vetëm për shkaqe të arsyeshme e të argumentuara

### **Neni 8**

#### **Marrja e informacionit, depozitimi dhe forma e saj**

1. Ankesat e ardhura pranë IKM-se, duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të përmbajnë të dhëna të rëndësishme, për fakte dhe rrethana të ekzistencës së një sjellje të keqe apo papajtueshmërie, mbi të cilën mund të gjykohet për kryerjen e një procesi investigimi.
2. Ankesa duhet të përmbajë minimalisht këto elemente:
  - a. Të dhëna mbi ankuesin, të identifikuar në mënyrë të qartë;
  - b. Të dhëna mbi subjektin e mbikëqyrjes objekt i ankesës;
  - c. Përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara dhe kohën e ndodhjes së tyre;
  - d. Dokumentet apo burimet mbështetëse të atyre fakteve apo rrethanave të pretenduara;
3. Gjatë procesit investigativ ankimesi mund të plotësojë dokumentacionin mbështetës me dokumenta të tjera që ai i gjykon të arsyeshme, si edhe me dokumentacione të tjera që mund ti kërkojnë në funksion të procesit të investigimit.
4. KID dhe struktura mbështetëse që mund të përfshihet në procesin e marrjes së ankesave duhet të ruajë konfidencialitetin e plotë të të dhënave të ankimesit deri në mbledhjen e evidencave dhe fakteve të cilat janë të domosdoshme për të arritur në një konkluzion.
5. Rastet e përgjithëshme kur ankesat vijnë të pa identifikuar nuk do të konsiderohen nga KD dhe nuk do të paraqiten KID për shqyrtim me përjashtim të atyre rasteve kur natyra e informacionit është e tillë që vihet në rrezik interesi publik dhe çënohet mënyra e organizimit dhe veprimtarisë së profesionit. Në këto raste KD kërkon informacion shtesë në mënyrë të pavarur nga të gjitha burimet ligjore dhe mbas mbledhjes së fakteve paraprake mund të propozojë KID nisjen e një procesi investigimi në përputhje me këtë rregullore.



6. Nëse KD gjykon që ka çështje të reja të pa trajtuara nga procesi fillestar i investigimit mund të kërkojë një investigim shtesë duke u siguruar që nuk ka proces ripërsëritje të procedurës dhe evidencës së grumbulluar. Në këto raste procedura bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm me kushtin që nuk ka përsëritje të procedurës dhe evidencës së grumbulluar.
7. Nëse KD gjykon që ka çështje të reja të pa trajtuara nga procesi i investigimit për ankesa ndaj anetarve të IKM, të cilat nuk janë ndjekur dhe shqyrtuar nga Komiteti i ngritur nga KD, shqyrtimi i tyre do të bëhet nga komiteti i auditimit. Në këto raste procedura bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm me kushtin që nuk ka përsëritje të procedurës dhe evidencës së grumbulluar.

#### **Neni 9**

#### **Kryerja e investigimit dhe dokumentimi i tij**

1. KID ka përgjegjësinë e trajtimit të sigurt dhe konfidencial të dokumentave dhe evidencës që merr nga palët.
2. KID gjatë kryerjes së procesit investigativ duhet të testojë nëse sjellja e anetarit/subjektit të mbikqyrjes ka dështuar të jetë e njëjtë me atë që do të kishte qënë parashikuar të ishte për rrethanat, në të cilën ka ndodhur apo rrjedhur ngjarjet.
3. Për të përmbushur misionin e tij, KID ka të drejtë t'u kërkojë anetarit/subjektit të mbikqyrur dhe palëve të treta informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në konkluzionet e duhura për çështjen që investigohet.
4. Subjektet e mbikqyrura, duhet të kooperojnë në proceset e investigimit, dhe t'u përgjigjen në kohë të arsyeshme të gjitha komunikimeve të bëra nga KID. Në rastet kur nuk bashkëpunojnë apo nuk i përgjigjen në kohë komunikimeve, i nënshtrohen sanksioneve të parashikuara për rastet e mosdhënies së informacionit apo dhënies së informacionit të gabuar.
5. Në përfundim të procesit KID dhe vë në dijeni duke adresuar rekomandimet për masat KD të IKM, bazuar në gjetejet dhe evidencën e dalë nga procesi i investigimit.
6. KD rishikon të gjithë evidencën dhe faktet e grumbulluara dhe mblidhet për të marrë vendim, i cili duhet të përmbajë dhe mendimin e KID nëse ka fakte apo rrethana që mund të cojnë në inicimin e një procesi disiplinor ndaj subjekteve të mbikqyrjes që janë përfshirë.



7. Propozimi i ardhur nga KID duhet të shoqërohet me një relacion përshkrues, i cili duhet të përmbajë:
- objektin e verifikimit;
  - pretendimet e ngritura nga ana e ankuesit;
  - pretendimet apo arsyetimet e mundshme të subjektit të mbikqyrjes;
  - referencë të dokumentave, faktet dhe rrethanat që përbëjnë shkelje në referim të ligjit dhe standarteve profesionale;
  - përmbledhjen e të dhënave kryesore të rastit të verifikuar;
  - përfundimet nëse ekzistojë në rastin konkret shkelje të ligjit, të standardeve teknike, profesionale dhe të kërkesave etike përfshirë edhe gjithë kuadrin rregullator të zbatueshëm si dhe vlerësimin nëse ato përbëjnë ose jo shkaqe të arsyeshme për marrjen e masave disiplinore;
  - propozimin lidhur me trajtimin e mëtejshëm të verifikimit.

#### **Neni 10** **E drejta e përfaqësimit**

1. Në kryerjen e investigimit KID udhëhiqet nga parimi i pjesëmarrjes së subjektit të mbikqyrjes të përfshirë në çështjen që investigohet, nëpërmjet vënies në dijeni, dëgjimit dhe verifikimit të pretendimeve të tij dhe të trajtimit të tij në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë.
2. Kur e gjykon të nevojshme KID organizon seanca dëgjimore të palëve të përfshira në procesin investigativ.
3. Përpara propozimit të masave prane KD, KID organizon të paktën një seancë dëgjimore të palëve të përfshira në procesin investigativ.

Njoftimi për organizimin e seancës dëgjimore dërgohet me shkrim të paktën 10 ditë përpara organizimit të saj.

4. Palët e përfshira në procesin investigativ kanë të drejtë që gjatë seancave dëgjimore të asistohen dhe/ose të përfaqësohen nga një këshilltar. KM objekt i ankesës mund të dëgjojë gjithashtu edhe dëshmitarë të tjerë ose të kërkojë paraqitjen e të dhënave të tjera, nëse është e nevojshme.
5. Në rastet e delegimit të të drejtës së përfaqësimit tek persona të tretë, ata duhet të paraqesin një autorizim me shkrim për të drejtën e përfaqësimit.






**Neni 11**

**Shqyrtimi nga KD dhe masat disiplinore**

1. Në përfundim të një procedure investigimi dhe përpilimit të propozimit KID, harton një raport, dhe përcakton propozimin për vendimin që duhet marrë.
2. Raporti së bashku me propozimin për masën që duhet marrë i dërgohen për shqyrtim KD i cili ka të drejtë të kërkoj dhe informacione shtesë kur e gjykon dhe mbi bazën e tyre jep edhe vendimin.
3. Kur raporti që shoqëron propozim e KID nuk është i plotë dhe mjaftueshmërisht i argumentuar, KD e kthen çështjen për rishqyrtim pranë KID dhe përcakton edhe afatet e këtij rishqyrtimi.
4. Nëse KD gjykon që ka çështje të reja të pa trajtuara nga procesi fillestar i investigimit mund të kërkoj një investigim shtesë duke u siguruar që nuk ka proces ripërsëritje të procedurës dhe evidencës së grumbulluar. Në këto raste procedura bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm me kushtin që nuk ka përsëritje të procedurës dhe evidencës së grumbulluar.
5. Vendimi i Keshillit të Drejtimit u bëhet i ditur personave të interesuar brenda pesëmbëdhjete ditëve nga data e mbledhjes që ka shqyrtuar çështjen.
6. Për të gjitha rastet e investiguara, për të cilat KD ka vendosur të ngarkojë me përgjegjësi anëtarin/subjektin e mbikqyrjes, dosja e investigimit që përmban rezultatet e verifikimeve dhe relacionin e KID-së së bashku me vendimin e KD-së, në të cilin është kategorizuar shkelja ruhen dhe dokumentohen pranë IKM-së.
7. Në rastet kur KID nuk propozon masa disiplinore ose masat disiplinore kanë natyrë rekomanduese, relacioni dorëzohet drejtpërdrejtë në KD pa pasur nevojën e një opinion ligjor. KD mund të vendosi nëse përpara se të marri vendim të kërkoj një mendim ligjor ose jo.



**Neni 12**

**Masat  
disiplinore**

1. Masat disiplinore  
janë:

- a) Keshillim, i cili perfshin rekomandim për përmiresim
  - b) Qortim : vërejtje dhe rekomandim për përmirësim pa shënim në regjistrin e IKM-se
  - c) Vërejtje me shënim në regjistrin e IKM-se;
  - d) KD mund te vendose gjobe per shkeljet e kryera nga KM; masa e gjobes percaktohet duke ju referuar Rregullores se BMP ne perpjestim me nivelin e shkeljes
  - e) Heqja e antarësisë nga IKM e cila realizohet me dy hapa:
    - (i) pezullim i përkohshëm, për një kohë jo më shumë se pesë vjet;
    - (ii) fshirje e përhershme nga regjistri publik, e cila përmban ndalimin, përgjithmonë, të ushtrimit të profesionit.
    - (iii) Keshilli i drejtimit të IKM i propozon BMP, ne perputhje me shkeljen e bere nga KM, pezullimin ose heqjen e te drejtes se ushtrimit te profesionit.
2. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “a” dhe “b”, të pikës 1, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “c” të pikës 1 dhe kanë një natyrë rekomanduese ose shmangie e cila mund të përmirsohet pa krijuar shkelje ligjore. Këto masa jepen kur subjekt i mbikëqyrjes ka bërë deklaram vullnetar (përpara nisjes së procesit të investigimit apo kontrollit të cilësisë) dhe/ose kur ka bërë përpjekjet më të mira , në se në mënyrë të arsyeshme ai nuk mund të bënte më shumë për të përmbushur një detyrim të caktuar që vjenë si rrjedhojë e kuadrit rregulator. Kostot e procesit të investigimit lidhur me shqyrtimin e këtyre shkeljeve mbulohen nga subjekti i mbikëqyrjes sipas preventivit të llogaritur nga personi përgjegjës për financën pranë IKM-së dhe të miratuar nga KD.
3. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret e parashikuara në paragrafin më sipër si dhe kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “d”, “e (i)”, “e (ii)” dhe “e (iii)”, të pikës 1.
4. Moszbatimi i detyrimeve ligjore nga anëtarët subjekt i mbikëqyrjes përbën një cënim të interesit publik. Në kuadër të mbrojtjes së interesit publik, IKM mbikëqyr veprimtarinë e antarëve/subjekteve që ushtrojnë profesionin KM dhe ofrojnë shërbime profesionale duke kërkuar informacion të plotë. Në rastet kur anëtarët/subjektet nuk japin informacionin apo dokumentacionin e kërkuar apo japin informacion të pasaktë bëhet shkak për cënimin e interesit publik dhe ndaj tyre ndërmerren hapat e nevojshëm ligjorë, deri në kallëzim penal.
5. Për të siguruar barazi në procesin e disiplinës dhe që masat e ndërmarra të jenë në proporcion me nivelin e shkeljes së etikës dhe të rregullave, Komiteti i Investigimit dhe



Disiplinës të IKM-së duhet të ndjekë të njëjtin parim në propozimin e masave disiplinore. Për këtë arsye, KID merr në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit duke përfshirë:

- a. Ndonjë faktor që e thëllon më shumë ose e zvogëlon rastin në fjalë;
- b. Rrethana personale të individit dhe të ndonjë personi tjetër që mund ta zvogëlojë rrethanat për individin ose shoqëritë p.sh rrethana që i takojnë deri në datën e marrjes së vendimit.
- c. Ndonjë referencë të siguruar për të mbështetur audituesin ligjor/shoqërinë e auditimit ose njësinë ekonomike.

### **Neni 13**

#### **Ndarja e niveleve të masave disiplinore**

1. Në këtë nen zërdhehen masat disiplinore sipas niveleve të shkeljes për shmangien e kryer.
2. Nivelet e shkeljes për qëllime të kësaj rregullore do të jenë si më poshtë:

- Këshillues
- I vogël
- I mesëm
- I madh
- I konsiderueshëm
- Kritik

Bazuar në këtë klasifikim zbatohen dhe gjobat përkatëse.

3. Përcaktimi dhe përshkrimi i nivelit të shkeljeve bëhet në përputhje me nenin 2 të rregullores nr 4 datë 29.03.2018 “Për Investigimin dhe Procedurat për Marrjen e Masave Disiplinore” të emetuar nga BMP .

### **Neni 14**

#### **E drejta e apelit**

Anëtari KM apo shoqëri KM, që ka marrë një masë disiplinore, mund të bëjë ankimim kundër vendimit të KD në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 15 diteve nga data e njoftimit zyrtar nga IKM.



**Neni 15**

**Kontrolli i zbatueshmerise te sistemit te I&D**

Për të kontrolluar nëse ka çështje për të cilat duhej të kishte filluar një proces investigimi dhe disipline dhe që nuk kanë filluar, apo për të shqyrtuar ecurinë e procesit të I&D gjatë vitit, ngarkohet Komiteti i Auditimit (KA) të IKM që të shqyrtojë zbatimin e procesit. KA gjatë kryerjes së aktivitet të vet duhet të përfshijë edhe kontrollin e zbatimit të sistemit të I&D nga KD dhe strukturat e tjera të IKM. Në raportin e auditimit për vitin raportues duhet të përfshihet nga KA edhe një pikë në lidhje me këtë kontroll të I&D dhe rezultatet përkatëse.

**Neni 16**

**Miratimi dhe Hyrja ne fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga KD i IKM. Ngarkohet KD dhe stafi ekzekutiv i IKM që të bëjnë të njohur të gjithë antarët e tij në lidhje me kërkesat e kësaj rregulloreje. Cdo rregullore e mëparshme e disiplinës dhe investigimi e IKM shfuqizohet.

Miratuar në Mbledhjen e KD

**Date 11.07.2019**

**Kryetari i Keshillit te Drejtimit**

**Prof.Dr. Sotiraq DHAMO**

